VENDIM
Nr. 760, datë 5.9.2013

PËR SHPËRBLIMIN E PRONARËVE MBI SIPËRFAQET TAKUESE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMET INFORMALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15/1 e 32 pika 1 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin e pronarëve mbi sipërfaqet takuese të pasurive të paluajtshme, pronë private, të zëna nga ndërtimet informale në Shkodër, Durrës, Elbasan, Dibër,Vlorë dhe Tiranë.

Pronarët e pasurive të paluajtshme, për sipërfaqen e zënë nga ndërtimet informale, të shpërblehen me këste nga fondi i kompensimit, në varësi të të ardhurave të arkëtuara nga transferimi i parcelave ndërtimore, sipas masës përkatëse që paraqitet në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 9 624.69 (nëntë mijë e gjashtëqind e njëzet e katër pikë gjashtëdhjetë e nëntë) m² tokë truall, me vlerë të përgjithshme prej 157 279 345.49 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind e dyzet e pesë pikë dyzet e nëntë) lekësh.

2. Vlera e përgjithshme e shpërblimit të përballohet nga fondi i kompensimit të pronave, të parashikuar nga ligji nr. 10 239, datë 25.2.2010 "Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave".

3. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në përputhje me këtë vendim, të kryejë ndryshimet përkatëse në regjistrat e pasurive të paluajtshme, për kalimin e pasurisë së paluajtshme të kompensuar në pronësi të shtetit.

4. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha